

Emri i Lëndës : Politikat dhe Institucionet e BE							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 421	C	Vjeshtë	3.00	0.00	0.00	3.00	6.00
Lektori		Gentjan Skara, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Program i Integruar					
Përshkrimi		Lënda synon të japë njohuri të thelluara dhe bashkëkohore për Bashkimin Evropian në këndvështrimin institucional dhe aspektin e politikave më të rëndësishme me qëllim që të përgatisë sa më mirë kandidatët për karrierë profesionale në këtë fushë si dhe me mundësinë e thellimit mbi çështjet europiane. Qëllimi i këtij kursi është gjithashtu të thellojë njohuritë mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimin e kuadrit institucional të Bashkimit Evropian, mbi problemet aktuale të reformimit të tyre, çështjet lidhur me politikën e zgjerimit si dhe të perspektivave të tij. Gjithashtu kursi synon që të paraqesë një panoramë të politikave kryesore të BE-së duke i parë se si kanë evoluar në aspektin historik.					
Objektivat		Objektivi kryesor i lëndës është që të paraqesë një panoramë të përgjithshme lidhur me teorinë; historinë, kuadrin institucional dhe politikën më të rëndësishme të Bashkimit Evropian. Nëpërmjet këtij kursi studentët do të zgjerojnë njohuritë e përgjithshme lidhur me teorinë dhe zhvillimin historik të BE-së. Gjithashtu do të kuptojnë kuadrin institucional dhe politikën kryesore të BE-së. Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë rëndësinë e tregut të brendshëm.					
Konceptet Kryesore		1. Bashkimi Evropian 2. Vlerat e Bashkimit Evropian 3. Procesi i Zgjerimit të Bashkimit Evropian 4. Komisioni 5. Parlamenti Evropian 6. Këshilli 7. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian 8. Tregu i brendshëm 9. Euro 10. Parimi i supremacisë					
Programi i Lëndës							
Java		Tema					
1		Prezantim i silabusit					
2		Hyrje: Integrimi Evropian nga Parisi në Lisbon Në këtë javë do të trajtohet procesi historik i zhvillimit të Bashkimit Evropian. Do të paraqitet një panoramë e përgjithshme e Europës pas luftës së dytë botërore dhe më pas do të diskutohet mbi arsyet kryesore që çuan në lindjen e Komunitetit të Qymyrit dhe Celikut dhe Komunitetit Ekonomik Evropian. Gjithashtu, në mënyrë historike do të trajtohen të gjithë amendimet e pasuara duke u fokusuar në risitë që sjell amendimi. Literatura përkatëse: 1. Klaus – Dieter Borchardt, ABC-ja e së Drejtës së Bashkimit Evropian (Ministria e Integritimit Evropian 2010) 9-18 2. Paul Craig and Grainne de Burca, EU Law: Text, Cases, and Materials (OUP 2015) 3-28.					
3		Anëtarësimi dhe Largimi në Bashkimin Evropian: Kushtet dhe Procedurat Zgjerimi i Bashkimit Evropian është një ndër temat më të diskutueshme. Gjatë këtij leksioni do të trajtohet në mënyrë kronologjike zgjerimi i Bashkimit Evropian. Si fillim do të shikohet baza ligjore e parashikuar në Traktatin Ekonomik Evropian dhe më pas do të analizohen kushtet e anëtarësimit dhe procedura e zgjerimit. Gjithashtu, në lëksion do të trajtohet edhe zgjerimi i BE-së drejt vendeve të Ballkanit Perëndimor. Krahas procedurës së zgjerimit, Traktati i Lisbonës, për herë të parë, parashikoi edhe procedurën e largimit. Një vështrim i përgjithshëm duke marrë si shembull Mbretërinë e Bashkuar, do të diskutohet në klasë lidhur me procedurën e largimit. Literatura përkatëse: 1. Pierre Mathijsen and Peter Dyrberg, Mathijsen’s Guide to European Union Law (Sweet and Maxwell 2013) 687-692.					

4	Vlerat dhe Objektivat e Bashkimit Europian; Kompetencat e BEsë Ky leksion do të fokusohet në vlerat dhe objektivat e Bashkimit Europian. Bashkimi Europian cilësohet si një klub me vlera të përbashkëta. Por këto vlera a janë të përbashkëta për 27 shtetet anëtare? Gjithashtu, në ditët e sotme ka një diskutim lidhur me objektivat dhe kompetencat e Bashkimit Europian. Traktati i Lisbonës solli një risi në këtë aspekt duke delimituar dhe klasifikuar kompetencat. Gjatë leksionit do të jepen edhe shembuj praktik në mënyrë që kompetencat të kuptohen sic duhet. Literatura përkatëse: 1. Klaus – Dieter Borchardt, ABC-ja e së Drejtës së Bashkimit Europian (Ministria e Integrimit Europian 2010) 19-44. 2. Paul Craig and Grainne de Burca, EU Law: Text, Cases, and Materials (OUP 2015) 73-103.
5	Kuadri Institucional i Bashkimit Evropian Në këtë leksion do të fokusohemi tek kuadri institucional i Bashkimit Europian. Është e rëndësishme që të sqarohet nëse ‘parimi i ndarjes së pushteteve’ ekziston edhe në Bashkimin Europian. Më pas, institucionet kryesore do të identifikohen duke shpjeguar i) evolimin e tyre historik; ii) përbërjen; dhe iii) kompetencat e këtyre institucioneve. Gjithashtu, krahas institucioneve kryesore, edhe dy institucione këshillimore si Komiteti i Rajoneve dhe Komiteti Ekonomik Social do të shpjegohen. Literatura përkatëse: 1. Klaus – Dieter Borchardt, ABC-ja e së Drejtës së Bashkimit Europian (Ministria e Integrimit Europian 2010) 45-81 2. Paul Craig and Grainne de Burca, EU Law: Text, Cases, and Materials (OUP 2015) 30-70.
6	Burimet e së drejtës dhe Mënyra e Vendimarrjes në BE Në këtë leksion do të shpjegohet burimet e së drejtës dhe mënyra e vendimarrjes dhe cilët janë aktorët kryesorë në këtë proces. Duke qenë që procesi i vendimarrjes është i veshtirë, një shembull praktik do të jepet në klasë. Studentët do të ndahen në grupe të cilët identifikojnë shtetet anëtare dhe Parlamentin. Më pas, do të votojnë për një çështje të caktuar. Literatura përkatëse: 1. Klaus – Dieter Borchardt, ABC-ja e së Drejtës së Bashkimit Europian (Ministria e Integrimit Europian 2010) 82-106 2. Paul Craig and Grainne de Burca, EU Law: Text, Cases, and Materials (OUP 2015) 105-160.
7	Parimi i zbatueshmërisë së drejtëpërdrjte, efektit të drejtëpërdrjte dhe parimi i supremacisë Në këtë javë do të trajtohet natyra e së drejtës së Bashkimit Europian. Me themelimin e Unionit, Shtetet Anëtare kanë kufizuar sovranitetin e tyre legjislativ dhe duke bërë këtë, kanë krijuar një organ të pavarur ligjor i cili është detyrues për ato, për qytetarët dhe për gjykatat e tyre. Për të kuptuar më mirë natyrën juridike, gjatë leksionit do të diskutohet mbi vendimet kryesore të GJED Literatura përkatëse: 1. Paul Craig and Grainne de Burca, EU Law: Text, Cases, and Materials (OUP 2015) 184-223; 266-314. Çështjet Gjyqësore: 1. Judgement of 5 February 1963, NV Algemene Transport- en Expeditie Onderneming van Gend & Loos v Netherlands Inland Revenue Administration, C-26/62, ECLI:EU:C:1963:1. 2. Judgment of 15 July 1964, Flaminio Costa v E.N.E.L, C-6/64, ECLI:EU:C:1964:66 3. Judgment of 4 December 1974, Yvonne van Duyn v Home Office, C-41/74, ECLI:EU:C:1974:133 4. Judgement of 9 March 1978, Amministrazione delle Finanze dello Stato v Simmenthal SpA, C-106/77, ECLI:EU:C:1978:49 5. Judgment of 10 April 1984, Sabine von Colson and Elisabeth Kamann v Land Nordrhein-Ėestfalen, C-14/83, ECLI:EU:C:1984:153
8	Gjysëm-final
9	Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca Në këtë leksion do të trajtohet rëndësia e tregut të brendshëm dhe konkurrenca për shtetet anëtare. Rendi juridik i Bashkimit Evropian bazohet mbi parimin e një tregu të brendshëm dhe të një konkurrencë të lirë. Rregullat e tregut të brendshëm janë të përbashkëta për të gjithë shtetet anëtare. Gjithashtu, në mënyrë që ky parim të jetë konkret është e nevojshme që tregu evropian të ketë rregulla që e mbrojnë atë nga shtrembërimi i konkurrencës. Në nivel të Bashkimit Europian konkurrenca mbrohet nga disa dispozita të Traktatit për funksionimin e Bashkimit Europian (101-109). Literatura përkatëse: 1. Paul Craig and Grainne de Burca, EU Law: Text, Cases, and Materials (OUP 2015) 607-636. 2. Pierre Mathijsen and Peter Dyrberg, Mathijsen’s Guide to European Union Law (Sweet and Maxwell 2013) 347-428.
10	Politika Rajonale dhe Kohezioni Ky leksion do të trajtojë politikën rajonale dhe kohezionin. Politika Europiane e Kohezionit që prej 60 vjetëve, përfaqëson një mekanizëm përdorur nga BE për të përmirësuar ekonominë e rajoneve të cilat ende mbeten prapa përsa i përket zhvillimit dhe rritjes socio-ekonomike. Nëpërmjet instrumenteve të saj kryesore, Politika e Kohezionit ka investuar në njerëz dhe komunitete në mbarë Europën, duke ndihmuar në krijimin e vendeve më të mira të mira të punës dhe të sigurojë një trajtim të barabartë për të gjithë qytetarët Europian. Kjo politikë ka si qëllim forcimin e ekonomisë Europiane, kohezionit social dhe territorial duke reduktuar pabarazitë mes rajoneve, referuar zonave rurale, rajoneve të prekura nga tranzicioni industrial, si dhe rajoneve që vuajnë nga probleme të theksuara permanente natyrore dhe demografike. Literatura përkatëse: 1. Paul Craig and Grainne de Burca, EU Law: Text, Cases, and Materials (OUP 2015) 573-585.

11	Politika e Përbashket e Agrikulturës Në këtë leksion do të trajtojmë Politikën e Përbashkët të Agrikulturës e cila e ka zanfillën që në vitin 1962 dhe është një partneritet midis bujqësisë dhe shoqërisë, dhe midis Evropës dhe fermerëve të saj. Nëpërmjet kësaj politike, Bashkimi Europian synon: i) të mbështesë fermerët dhe përmirësojnë produktivitetin bujqësor, duke siguruar një furnizim të qëndrueshëm të ushqimit të përballueshëm; ii) mbrojtë fermerët e Bashkimit Europian për të siguruar një jetesë të arsyeshme; iii) të ndihmojë në trajtimin e ndryshimit të klimës dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore; iv) mirëmbajtja e zonave rurale dhe peizazheve në të gjithë BE-në; dhe v) mbajtja gjallë e ekonomisë rurale duke promovuar punë në bujqësi, industri agroushqimore dhe sektorë të lidhur. Literatura përkatëse: 1. Pierre Mathijsen and Peter Dyrberg, Mathijsen's Guide to European Union Law (Sweet and Maxwell 2013) 429-445.
12	Bashkimi Monetar dhe Ekonomik Bashkimi Monetar dhe Ekonomik është një tjetër politikë që do të trajtohet gjatë këtij kursi. Kjo politikë daton që me hyrjen në fuqi të Traktati i Mاستrihtit pasi me të, nisi rruga që do të çonte në vitin 2002 në hyrjen në qarkullim të monedhës së përbashkët europiane, Euro. Euroja është një karakteristikë e njohur e jetës së përditshme, e cila përdoret nga më se 332 milionë qytetarë të BE-së për nevojat e tyre ditore, për të kursyer për të nesërmen dhe për të investuar në të ardhmen. Gjatë leksionit, do të trajtohet edhe pse disa shtete kanë preferuar që mos të përdorin Euron dhe të shpjegohet impakti i krizës ekonomike në funksionimin e Bashkimit Europian. Literatura përkatëse: 1. Pierre Mathijsen and Peter Dyrberg, Mathijsen's Guide to European Union Law (Sweet and Maxwell 2013) 507-517.
13	Politika e Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme Në këtë leksion do të trajtohet Politika e Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme. Termi "Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme" përdoret gjerësisht sot për t'iu referuar kuadrit të rregullave të Bashkimit Europian që lidhen me politikat e përbashkëta të azilit, migracionit, luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit. Problematika e Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme përbën një nga fushat më të ndjeshme për BE. Studentët do të njihen më bazën ligjore dhe sfidat më të cilat po përballën institucionet e Bashkimit europian. Literatura përkatëse: 1. Paul Craig and Grainne de Burca, EU Law: Text, Cases, and Materials (OUP 2015) 964-1000.
14	Politika e Jashtme e BE-së Në këtë leksion do të trajtohet Politika e jashtme e BE-së. Politika e Përbashkët për Punë të Jashtme dhe Siguri (CFSP) e Bashkimit Evropian është themeluar me miratimin e Traktatit të Maastricht-it në vitin 1992. Qëllimet që synohet të realizohen përmes saj janë: të ruhet paqja dhe fuqizimi i sigurisë ndërkombëtare në pajtim me parimet e Konventës së Kombeve të Bashkuara; promovimin e bashkëpunimit ndërkombëtarë; dhe për zhvillimin dhe konsolidimin e demokracisë, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore. Gjatë leksionit do të trajtohen misionet civile dhe ushtarake të atashuara nga në kuader të CFSP dhe do diskutohet nëse Politika e Përbashkët për Punë të Jashtme dhe Siguri ka qene efikase. Literatura përkatëse: 1. Pierre Mathijsen and Peter Dyrberg, Mathijsen's Guide to European Union Law (Sweet and Maxwell 2013) 629-652
15	Politika e Mjedisit Ky leksion trajton politikën e mjedisit në Bashkimin Europian. Gjatë prezantimit do të shpjegohet zhvillimi historik i politikës së mjedisit, baza ligjore dhe parimet themelore në të cilën bazohet e drejta e mjedisit në Bashkimit Europian. Literatura përkatëse: 1. Pierre Mathijsen and Peter Dyrberg, Mathijsen's Guide to European Union Law (Sweet and Maxwell 2013) 599-614
16	Provim Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• Paul Craig and Grainne de Burca, EU Law: Text, Cases, and Materials (OUP 2015) • Klaus – Dieter Borchardt, ABC-ja e së Drejtës së Bashkimit Evropian (Ministria e Integritetit Evropian 2010) 82 • Pierre Mathijsen and Peter Dyrberg, Mathijsen's Guide to European Union Law (Sweet and Maxwell 2013) • Consolidated Version of the Treaty on European Union [2008] OJ C115/13
Referenca të tjera	• Judgement of 5 February 1963, NV Algemene Transport- en Expeditie Onderneming van Gend & Loos v Netherlands Inland Revenue Administration, C-26/62, ECLI:EU:C:1963:1 • Judgment of 15 July 1964, Flaminio Costa v E.N.E.L, C-6/64, ECLI:EU:C:1964:66 • Judgment of 4 December 1974, Yvonne van Duyn v Home Office, C-41/74, ECLI:EU:C:1974:133 • Judgement of 9 March 1978, Amministrazione delle Finanze dello Stato v Simmenthal SpA, C-106/77, ECLI:EU:C:1978:49 • Judgment of 10 April 1984, Sabine von Colson and Elisabeth Kamann v Land Nordrhein-Ėestfalen, C-14/83, ECLI:EU:C:1984:153
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Pas përfundimit të kursit, studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë vlerat, objektivat dhe rëndësinë e Tregut të Përbashkët Evropian
2	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që të kuptojnë procesin integruar dhe rolin e shteteve anëtare në këtë proces
3	Pas përfundimit të kursit, studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë zhvillimin dhe funksionimin e kuadrit institucional të Bashkimit Evropian
4	Pas përfundimit të kursit, studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë zhvillimin dhe funksionimin e politikave të Bashkimit Evropian
5	Pas përfundimit të kursit, studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë funksionimin e Tregut të Përbashkët Evropian dhe të kenë informacion në politikën e jashtme, të drejtësisë, mjedisit dhe agrikulturës.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	35	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			45
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			55
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	17	17
Provimi final	1	29	29
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			150
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6.00
ECTS			6.00